



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR

Nr. 1110 Prot,

Gjirokastër, më 29.02.2024

Lënda: Dërgohet analiza vjetore 2023.

PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
Z. Olsian ÇELA

TIRANË

I nderuar z. Prokurator i Përgjithshëm!

Bashkëlidhur me këtë shkresë, ju përjcellim analizën e treguesve kryesorë të punës së Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për vitin 2023.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

DREJTUESI I PROKURORISË


Petrit ÇANO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM GJIROKASTËR**

ANALIZË

**E TREGUESVE KRYESORË TË PUNËS SË PROKURORISË PRANE GJYKATES SE
SHKALLES SE PARE TE JURIDIKSIONIT TE PERGJITHSHEM
GJIROKASTËR PËR VITIN 2023**

**PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
z. Olsian ÇELA**

TIRANË

I nderuar Z. Prokuror i Përgjithshem!

Në mbyllje të vitit 2023 në zbatim të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” paraqes para Jush këtë material në të cilin përcaktohen arritjet dhe objektivat e realizuara gjatë ushtrimit të ndjekjes penale në fazën e hetimit paraprak dhe në gjykim, kryerjen e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore si dhe analizohen treguesit sasiorë dhe cilësorë në përgjithësi dhe në veçanti për secilin prokuror.

Kjo analize është bazuar në drejtimet dhe përparesitë tona në luftën kundër kriminalitetit dhe ka për qëllim përgjithësimin e përvojës pozitive, por njëkohësisht edhe evidentimin e mangësive dhe problemëve që kanë lindur gjatë këtij viti gjyqësor me synimin e vetëm përmirësimin e vazhdueshëm të treguesve dhe goditjen në kohë dhe me efikasitet të veprave kriminale në territorin e Rrethit Gjyqësor në të cilin ajo ushtron aktivitetin e saj.

Në qendër të vëmendjes tonë gjatë vitit që analizojmë kanë qenë zbatimi me rigorozitet i Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave “*Për luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023*”, dhe planit të veprimit për zbatim të këtyre rekomandimeve i miratuar me Urdherin nr.2/2023.

Gjatë vitit 2023 në lidhje me zbatimin e këtyre prioritetëve ka rezultuar se :

NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT

- Gjate ketij viti jane trajtuar gjithesej 7 (shtate) raste per vepren penale te korrupsionit nga te cilat 6 (gjashte) raste per “Korrupsion aktiv te personave qe ushtrojne funksione publike”, parashikuar nga neni 244 i K.Penal dhe 1 (nje) rast per vepren penale te “Korrupsionit aktiv te funksionareve te larte shterore ose te zgjedhurve vendore”, parashikuar nga neni 245 te K.Penal. Nga keto 3 (tre) procedime penale jane derguar per gjykim me 3 (tre) persona te pandehur, per nje rast eshte kerkuar pushimi i procedimit dhe per 3 (tre) procedimet e tjera hetimet vazhdojne.

- Po keshtu ne krahasim me vitin e kaluar numri hetimeve proaktive ka qenë me i larte, janë regjistruar **30 (tridhjetë)** të tillë kryesisht për veprat penale ne fushën e narkotikëve dhe trafikimin e klandestinëve, vepra penale keto nga me te perhapurat ne territorin ku ushtron aktivitetin kjo Prokurori, për te rritur efektivitetin dhe zbulueshtmerine për këtë grup veprash penale. Hetime te tilla kanë dhënë rezultate të kenaqshme mbasi rezulton të jenë arrestuar personat e dyshuar që kryenin veprat penale të parashikuara në nenet 283 dhe 298 te Kodit Penal..

Përvec sa sipër kemi në hetim **51 (pesëdhjetë e një) procedime** penale për veprën penale “Pastrimi produkteve te vepres penale dhe veprimtarise kriminale”, parashikuar nga neni 287 i K.Penal, nga të cilat **42(dyzetë e dy)** procedime të mbartuara nga vitet paraardhëse dhe **9(nëntë)** procedime të regjistruara gjatë vitit 2023. Gjithashtu janë **10(dhjetë)** raste të hetimeve pasurore të regjistruara gjatë vitit 2023 për veprat penale që lidhen kryesisht me narkotikët por edhe me vepra të tjera penale. Per kete kategori veprash ecuaria ka qene e ngadalte , eshte perfunduar vetem nje procedim per vepren penale te parashikuar nga neni 287 i K.Penal si dhe nje rast hetimi pasuror.

Në lidhje me këtë referuar Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshem nr.10, dt.17.07.2020 eshte informuar ne menyre permantente personi i kontaktit ne Prokurorine e Përgjithshme, është ne në funksion regjistri i posaçem dhe janë orinetuar prokuroret që në gjitha rastet kur konstatohen pasuri të vëna nga aktiviteti kriminal te fillojne menjëhere hetimet.

Gjithësesi duhet pranuar që për këtë kategori veprash rezultatet nuk kanë qenë ato që priten dhe qe janë përcaktuar si prioritare edhe në Rekomandimet e Keshillit të Ministrave për luftën ndaj kriminalitetit. Ka zvarritje të pajustificueshme në hetim, ka mungese profesionalizmi nga oficerët e policisë gjyqësore qe kryejne hetimin , nuk ka struktura te posaçme në Polici dhe oficerë të trainuar, ndodh qe ne shume raste prokuroret nuk adresojne dot oficerin të cilit do ti delegohet çështja. Ne shume raste pergjigjet nga organet ne te cilat kerkohet informacion vijne me vonese dhe po keshtu zvarrtje jane krijuar dhe nga ekspertet kontabel te thirrur per te bere aktet perkatese ne kuader te ketyre çështjeve.

- Ne kuader te zbatimit te planit te veprimit me EUROJUST janë marre masa për sigurimin e kushteve te nevojshme për sigurine e te dhenave personale. Ne këtë kuader është trainuar përsoni qe do te merret me zbatimin e ketij plani si dhe eshte pergatitur regjistri për komunikimet me Eurojust. Deri tani nuk kemi pasur raste te tille.

- Nuk kemi pasur ndonjë rast të zbatimit të Ligjit 108/2016 ‘ Për vendosjen në regjim te posaçem të të dënuarve/paraburgosurve për veprat penale të parashikuara nga ky ligj.

- Gjate kesaj periudhe jane bere perpjekje te vazhdueshme per te siguruar akses ne databazet e shtetërore per marrjen ne kohe te informacioneve te kerkuara me qellim kryerjen e hetimeve të shpejta dhe me efektivitet. Funksionon normalisht sistemi per gjendjen gjyqesore , lidhja me sistemin E- Albania, me ASHK-ne por duhet theksuasr se mungon aksesit per prokuroret ne sistemin TIMS per shkak te

mungeses se pajisjes me çertifikate sigurie. Akses ka vetem nje oficer i policise gjyqesore i kesaj Prokurorie. Gjendja e pajisjeve informatike per prokuroret dhe oficeret eshte optimale dhe ndihmon dukshem ne aktivitetin e tyre.

- Ne fushën e garantimit të pavaresisë dhe përgjegjshmërisë së prokurorëve është synuar rregullimi i mardhënieve ndërmjet prokurorëve dhe drejtuesit të Prokurorisë për të siguruar një atmosfere transparente dhe besimi reciprok, rritja e rolit aktiv të tyre në hetimet paraprake dhe në gjykim, forcimi i standarteve te etikes, njohja dhe zbatimi me rigorozitet i Udhezimeve te Prokurorit te Përgjithshem.

- Per kete qellim mbi bazen e Udhezimit nr.02/2023 te Prokurorit te Pergjithshem per te lehtesuar zbatimin e Rekomandimeve Prioritare te Keshillit te Mistrave eshte hartuar edhe nje Udhezim i Pergjithshem nga Drejtuesi i Prokurorise. Ne kuadrin e masave qe sigurojne zbatimin e ketyre rekomandimeve Drejtuesi i Prokurorise ne menyre periodike ka kontrolluar ecurine e procedimeve, ka bashkerenduar punen me organet e tjera ligjzbatuese dhe Prokurorite respektive, ka dhene udhese per çeshtje te veçanta dhe ne b/punim me prokuroret ka organizuar takime me oficeret e policise gjyqesore me qellim evadimin ne kohe te çeshtjeve dhe zgjidhjen e problematikave qe hasen.

- Ne kete kuader jane nxjerre Udhese jo te detyrueshme per çeshtje konkrete ne **3** (tre) raste dhe ne **5** (pesë) raste eshte kerkuar informacion per ecurine e hetimeve per çeshtje konkrete nga me problematiket, perfshi ketu edhe çeshtjet e mbartura nga vitet e kaluara te cilat rrisin ngarkesen e çdo prokurori dhe cenojne interesat e paleve ne proces. Per kete qellim janë zhvilluar **10** (dhjetë) mbledhje me prokurorët dhe ne **4** (katër) raste jane organizuar takime te veçanta me oficeret e policise gjyqesore te Sherbimeve te Policise se Shtetit si dhe me oficeret e Seksionit te Prokurorise. Eshte terhequr vemendja oficerave te Seksionit per zvarritje te hetimeve dhe ne **5** (pese) raste eshte urdheruar nga Drejtuesi kryerja e veprimeve hetimore te nevojshme ne kuader te ketyre çeshtjeve.

-Po keshthu ne zbatim te Udhezimit te Pergjithshem nr.03, dt.29.12.2016 "*Per ndarjen e çeshtjeve ne prokurori*" ka vazhduar ne menyre te rregullt perdorimi i shortit elektronik ne shperndarjen e çeshtjeve si dhe ai manual ne rastet kur shperndarja eshte e pamundur ne menyre elektronike. Me konkretisht kjo e fundit eshte zbatuar për shpërndarjen e çështjeve të prokurorëve të transferuar në prokurori të tjera gjatë vitit 2023.

- Ne zbatim te Udhezimit te Pergjithshem nr.08/2020, ndryshuar me Udhezimim nr.06/2021 "*Per shpenzimet procedurale*" ka filluar aplikimi i raportimit periodik te shpenzimeve procedurale nga Zyra e Finances se Prokurorise ne Drejtorine Ekonomike dhe Financiare ne Prokurorine e Pergjithshme

- Prokuroret kane bere perpjekje qe ne zbatim te Udhezimit te Pergjithshem nr.05/2020 te permiresojne sherbimet e ekspertizes ne funksion te nje hetimi sa me profesional kryesisht ne fushen e krimeve ekonomko-financiare, te shkeljes se rregullave te qarkullimit rrugor dhe ne te gjitha rastet e tjera ku kerkohet ky sherbim dhe kjo gje ka ndikuar ne rritjen e efektivitetit te ndjekjes penale.

Ne zbatim te Udhezimit te Pergjithshem nr.10 te vitit 2021 te Prokurorit te Pergjithshem jane marre masa per monitorimin dhe treguesit e zbatimit nga prokuroret dhe oficeret e Policise gjyqesore te Udhezimeve te Prokurorit te Pergjithshem sipas fushave dhe prioriteve te rekomanduara dhe aktmareveshjeve te perbashketa nderinstitucionale.

PËR FORCIMIN E RESPEKTIMIT TE TE DREJTAVE TE NJERIUT

- Gjate kesaj periudhe eshte aplikuar ne **10** raste gjykimi me marreveshje. Eshte aplikuar gjithashtu ne **5** raste urdheri penal, ne **5** raste eshte proceduar me gjykim te drejtperdrejte dhe ne **143** raste eshte aplikuar gjykimi i shkurtuar. Ne kete drejtim treguesit nuk jane ato qe duhet te ishin, do te jete objektiv per vitin 2024 e ne vazhdim aplikimi ne me shume raste.

- Jane **118** kerkesa te prokurorit per dhenien e denimeve alternative per autore dhe vepra penale me rrezikshmeri te ulet shoqerore duke shenuar rritje ne krahasim me te njeten periudhe te vitit te kaluar.

- Gjate vitit 2023 jane regjistruar **41** kallelzime per autore dhe viktima te mitur nga te cilet per **32** raste eshte regjistruar procedimi penal , me **30** autore. Jane derguar ne gjykim **7** çeshtje me autore dhe viktima te mitur per veprat penale **100/2, 108/a/2, 130/a/4, 134/1,2, 89, 301, 305/b dhe 291 te K.Penal.**

Ne **14** (katërmbedhete raste) eshte vendosur shmangja nga denimi e te miturve autore te vepres penale , konkretisht per veprat penale parashikuar nga neni 291, 134 te K.Penal.

Hetimet per kete kategori personash kane perfunduar brenda afateve te parashikuara ne ligj. Jane garantuar te drejtat procedurale te te miturve , deshmitare dhe viktima te vepres penale. Ndhimese e madhe ne kete drejtim ka qene edhe roli i kordinatorëve te viktimave te cilet me pervojen e tyre i kane krijuar kesaj kategorie nje ambient me te pershtatshem. Duhet permendur fakti qe prokurorja **Blerina Musabelli** dhe oficeri **Erlin Lani** te caktuar ne kete Seksion kane bere nje pune te lavderueshme per perfundimin brenda afateve ligjore te ketyre çeshtjeve por edhe cilesine e trajtimit te tyre.

- Jane **46** (dyzete e gjashte) procedime penale per vepren penale “Dhuna ne familje”, parashikuar nga neni 130/a te K.Penal, me **11** persona nen hetim dhe **26** te pandehur. Per **25** (njezete e pese) procedime jane perfunduar hetimet dhe jane derguar per gjykim, te tjerat jane ende ne hetim. Te demtuar – viktima si rast i dhunes ne familje jane **14** femra. Jane gjithashtu **5** (pese) procedime te regjistruar per vepren penale “Perndjekja” sipas nenit **121/a** te K.Penal me **5** (pese) autor nga te cilet **1**(nje) ne masen e sigurise “arrest ne burg” dhe **1** (nje) procedim qe eshte perfunduar, derguar per gjykim dhe denuar.

PËR FORCIMIN E BASHKEPUNIMIT NDERINSTITUCIONAL

- Janë përmiresuar ndjeshem raportet me Policine e Shtetit. Këtë e tregon edhe fakti qe ne b/punim këtë vit kemi arritur te realizojme me sukses një numer jo te vogel procedime proaktive me një numer te larte personash te proceduar dhe te arrestuar.

- Është rritur b/punimi edhe me organizma te tjerë ligjzbatues ne veçanti me Prokurorine e Posaçme SPAK me te cilen eshte shkëmbyer informacion per çeshtje te ndryshme ne hetim. Gjate vitit qe po analizojme kemi derguar ne Prokurorine Speciale per mungese te kompetences lendore 3 (tre) procedime penale per veprat penale te parashikuara nga nenet 135, 258, 328, 248 te K.Penal dhe jane percjelle nga kjo strukture 11 materiale hetimore/kallzime per vepra te ndryshme penale te parashikuara nga nenet 245/1, 248, dhe 135 te Kodit Penal, nga te cilat per nje procedim pas hetimeve te zhvilluara eshte percjelle per kompetence Prokurorise se Posaçme.

- Përsa i përket trainimit te prokuroreve dhe oficerëve te policisë gjyqësore për këtë kategori veprash penale rezulton se prokurore dhe oficerë te kesaj prokurorie kanë ndjekur tema te vecanta ne trainimin vazhdues ne Shkollen e Magjistratures por edhe ne aktivitete te organizuara nga organizma te vecante vendas dhe te huaj qe merren me këtë aktivitet, përfshi këtu Ministrine e Drejtesise, Euralius, Opdat etj.

- Eshte rritur gjithashtu b/punimi me Zyren e Inspektorit te Larte te Drejtesise duke i vene ne dispozicion te gjitha materialet e kerkuara ne lidhje me kontrollet e ushtruara ne kete Prokurori por

edhe per rastet e ankesave nga qytetaret si dhe me Keshillin e Larte te Prokurorise ne shkembimin e opinioneve per menyren e vleresimit te Prokuroreve dhe ne fusha te tjera. Gjate ketij viti nuk kemi pasur raste te kallezuara nga Inspektoriati i Larte i Deklarimit te Pasurive dhe Kontrolli i Larte i Shtetit nderkohe qe është regjistruar 1 (një) çeshtje mbi bazen e materialeve te ardhura nga Ministria e Drejtesise ne lidhje me abuzimin me detyren te nepunesve lokale çeshtje e cila vazhdon te jete ne hetim. Nuk kemi pasur ankesa tek Institucioni i Avokatit te Popullit dhe as raste te rekomandimeve te ketij Institucioni apo te Organizatave te tjera jo fitimpruese te perfisshira ne veprimtarine e mbrojtjes se te drejtave te njeriut. Ne një mase te madhe procedimet penale janë regjistruar mbi bazen e materialeve te referuara nga organet e Policisë se Shtetit, pjesa tjeter nga kallezimet e qytetareve ne Prokurori si dhe ne raste me te pakta nga insitucinet e tjera publike dhe private.

- Ne këtë kuader rendesi e vecante u është kushtuar ceshtjeve më problematike që shqetësojnë komunitetin e këtij rrethi që jane, veprat penale **kundër rendit dhe sigurise publike** ku prioritet kanë qenë veprat penale në fushën e **narkotikeve, veprat penale qe lidhen me kontrabandimin e qenjeve njerezore (neni 298 i K.Penal)**, **veprat penale kunder jetes dhe shendetit, ato që lidhen me prodhimin dhe mbajtjen pa leje te armeve luftarake dhe municionit, veprat penale ne fushën e veprimtarisë shtetërore të kryera nga nëpunësit shtetërorë, veprat penale kundër femijeve, martesës dhe familjes, veprat penale kundër mjedisit, veprat penale, ne fushen e sferes ekonomike etj**

Duke zbatuar detyrimin kushtetues si autoriteti i vetëm për ushtrimin e ndjekjes penale, kemi qenë të angazhuar për të kryer një hetim sa më të plotë dhe të gjithanshëm, për të gjitha procedimet e trajtuara gjatë këtij viti duke u dhënë përparësi hetimeve proaktive ne veprat penale ne vecanti ne hetimin e veprave penale ne fushën e kultivimit, prodhimit dhe shitjes se narkotikeve por edhe te kontrabandimit te klandestineve dhe krimet ne fushen e doganave te cilat ne Qarkun tone rezultojne me përhapje jo te vogel. Ne këtë kuader janë kryer hetime serioze për te përcaktuar pergjegjesine qe kanë drejtuesit dhe nepunesit vendore ne kontrollin e teritorit qe mbulojne për te mos lejuar ushtrimin e aktiviteteve te paligjshme ne fushën e narkotikeve dhe te mjedisit si dhe ne sigurine jetes dhe shendetit te qytetareve

Po kështu janë bërë përpjekje për të rritur nivelin e përfaqesimit të akuzes në gjykim, për të ekzekutuar në kohë vendimet penale të gjykatave , për të mbikqyrur në vazhdimësi vuajtjen e dënimit të të dënuarve si dhe për të bashkerenduar punën me të gjithë aktorët e tjerë të luftes kundër kriminalitetit përfshi këtu Policine e Shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese. Rëndesi i është kushtuar edhe përmbushjes së detyrimëve lidhur me mardhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën e zbatimit të leterporosive, ekstradimeve, njohjes së vendimeve penale të huaja etj.

Krahas kësaj, në përputhje me detyrimet e parashikuara shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin procedural penal jemi përpjekur që në veprimtarinë tonë të respektojmë të gjitha kërkesat e një procesi të rregullt ligjor si ndaj personave të dyshuar si autorë të veprave penale duke u garantuar të gjitha të drejtat që iu njeh ligji dhe duke ndërhyrë në të gjitha rastet kur të drejtat e tyre janë cënuar nga organe të tjera edhe ndaj viktimave te ketyre veprave duke u dhënë prioritet shtresave me vunerabel te shoqerise si te miturve, grave apo personave qe nuk kanë mundesi për tu mbrojtur.

Për veprat penale të rënda me ndjeshmëri të madhe në opinionin publik e shoqëror te përmendura me sipër kemi bërë përpjekje serioze që hetimet t'i përfundojmë shpejt e me cilësi, duke zbatuar një

politikë ndëshkimi në përputhje me rëndësinë e faktit dhe efektet për parandalimin e tyre me qëllimin e vetëm për të garantuar një jete të sigurve dhe me sa më pak probleme për komunitetin.


Gjatë këtij viti që po analizojmë ka vazhduar implementimi i ligjeve të reja në kuadrin e Reformës në Drejtësi të cilat kanë sjelle shumë ndryshime në aktivitetin procedural të Organit të Prokurorisë. Në këtë kuader janë bërë përpjekje serioze për të garantuar pavarësinë e prokuroreve në vendimarrje. Po kështu rëndësi e vecante i është kushtuar zbatimit në praktike të risive të reja që ka sjelle ndryshimi i K.Pr.Penale si dhe zbatimi i Hartes së Re gjyqësore. Siç dihet me Prokurorinë e Gjyroskastres në 1 maj të vitit 2023 u bashkua edhe ish Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Permet duke krijuar atë që tani emërtohet si Prokuroria Prane Gjykatës së Shkalles së Psre të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjyroskaster. Procesi i shkrirjes së këtyre dy institucioneve në një të vetëm ka shkuar normalisht duke respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Ligji dhe Udhezimi i Prokurorit të Përgjithshëm i nxjerre në zbatim të ligjit.

TË DHËNA STATISTIKORE DHE GRAFIKE TË USHTRIMIT TË NDJEKJES PENALE GJATË VITIT 2023

- Gjatë këtij viti të cilin po analizojmë kjo Zyrë ka ushtruar ndjekjen penale për **618** procedime me **370 (197+173)** persona të pandehur dhe nën hetim nga **600** procedime të vitit 2022 me **313 (163+150)** persona nën hetim dhe të pandehur. Nga sa shihet ka një rritje të lehtë të numrit të çështjeve penale të regjistruara dhe gjithashtu rritje të personave nën hetim dhe të pandehurve, duke marrë parasysh faktin se nga data 01.05.2023, në kompetencën territoriale të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjyroskaster është shtuar dhe rrethi i Përmetit, cka ka sjellë edhe ngarkesën e veprave penale të konsumuara në këtë territor që përpara implementimit të hartës së re gjyqësore ishin në kompetencën territoriale të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Përmet.



TË DHËNA KRAHASIMORE PËR VOLUMIN E ÇËSHTJEVE TË RREGJISTRUARA DHE TË MBARTURA NË KRAHASIM ME VITIN 2022




Në një këndvështrim të përgjithshëm veprat penale më të përhapura gjatë këtij viti kanë qenë:


- = **veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike** gjithsej **192** procedime nga të cilat **9** procedime për “Kultivim të bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i K.Penal, **29** procedime për “Prodhim dhe shitje të narkotikeve”, parashikuar nga neni 283 i K.Penal, **22** procedime për “Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290 i K.Penal, **70** procedime për veprën penale “Drejtimi automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i K.Penal, **12** procedime për nenet 278, 278/a, 279, 280 të K.Penal, **36** procedime për nenin 298 të K.Penal, **5** procedime për nenin 277 të K.Penal dhe **9** procedime për nenin 287 të K.Penal etj,
- = **veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike** gjithsej **131** procedime ku numrin më të madh e zënë ato të parashikuara nga neni 134 i K.Penal (vjedhje pasurisë) **67** procedime, neni 137 i Kodit Penal (Vjedhje energjis elektrike) **7** procedime , (veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndertimeve) **20** procedime, nenet 150-162 (shkatërrimi i pronës) **23** procedime, neni 143 i Kodit Penal (mashtrimi) **14** procedime,
- = **krimet kundër jetës dhe shëndetit** **24** procedime, përkatësisht, **3** procedime penale për nenin 79/c të Kodit Penal, **6** procedime penale për nenin 84 të Kodit Penal, **4** procedime penale për nenin 88 të Kodit Penal, **10** procedime për nenin 89 të Kodit Penal .
- = **veprat penale kundër drejtësisë** gjithsej **19** procedime të rregjistruara, përkatësisht, **9** procedime penale për nenin 323 të Kodit Penal, **5** procedime penale për nenin 321 të Kodit Penal, **2** procedime penale për nenin 320 të Kodit Penal dhe nga **1** procedim për nenet 305, 312/a dhe 318 të Kodit Penal.

- **krimet kundër veprimtarise shtetere te kryera nga punonjësit shtetror** gjithsej **21** procedime ku të gjithë numrin e zene ato te parashikuara nga neni 248 i K.Penal (Shpërdorimi i detyres).
- **krimet në fushën e falsifikimit të dokumentave** gjithsej **14** procedime penale, përkatësisht **9** procedime për nenin 186 të Kodit Penal, **1** procedim për nenin 186/a/1 të Kodit Penal, **2** procedime për nenin 190/1 të Kodit Penal, **1** procedim për nenin 191/1 të Kodit Penal dhe **1** procedim për nenin 192/b/1 të Kodit Penal.
- **Krimet në fushën doganore** gjithsej **23** procedime penale, përkatësisht **6** procedime për nenin 174/1 të Kodit Penal, **1** procedim për nenin 175 të Kodit Penal, **2** procedime për nenin 178/1 të Kodit Penal dhe **14** procedime për nenin 179/a të Kodit Penal.


Më poshtë paraqitet në mënyrë grafike përhapja e veprave penale në Qarkun e Gjirokastrës gjatë vitit 2023 dhe krahasimin e tyre me vitin 2022 për të parë më mirë tendencat për çdo grup vepre penale.




Veprat penale krahasuar me vitin 2022:



Më poshtë do të paraqitet në mënyrë grafike numri i veprave penale sipas kapitujve dhe seksioneve të Kodit Penal.



Konkretisht, figurat e veprave penale më të përhapura janë si më poshtë:



Nga hetimet e kryera për këto kategori veprash penale tregojnë se shkaqet e përhapjes së tyre janë të ndryshme, sociale dhe ekonomike, probleme të mosfunksionimit të organeve të qeverisjes vendore dhe organizmave të tjerë ligjzbatues, probleme të infrastrukturës dhe edukimit të pamjaftueshëm në respektimin e rregullave të qarkullimit rrugor nga drejtuesit e mjeteve, por edhe nga shtetasit, mosfunksionimi i rregullt i strukturave të ndryshme shtetërore që mbikqyrin veprimtari të palejuara dhe në shkelje të ligjit, etj. Po kështu edhe kontigjenti i personave që kanë kryer këto vepra penale rezulton të jetë kryesisht i moshës 18-60 vjeç me nivel të ulët arsimor dhe kulturor, kryesisht banorë të Njësisve Administrative të fshatrave përreth qyteteve të Gjirokastrës, Tepelenës, Përmetit, Libohovës, Memaliaj dhe Këlcyrës dhe Bashkisë Dropull. Numeri i personave me arsim të lartë të dyshuar apo të akuzuar si autore të veprave penale është i ulët dhe kryesisht janë punonjës të administratës vendore që janë akuzuar për vepra penale në lidhje me detyrën e tyre.

Në regjistrat e kësaj prokurorie janë regjistruar për **vitin 2023** gjithsej **618** procedime penale me **370** persona nën hetim, nga të cilët **173** persona të pandehur dhe **62** kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në burg”.


Nga **viti 2022** janë mbartur gjithsej **761** procedime penale me **272** persona nën hetim, nga të cilët **174** të pandehur dhe **61** kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në burg”.

NË TOTAL:

Gjatë vitit 2023 duke përfshirë edhe çështjet e mbartura është ushtruar ndjekja penale në hetimin paraprak për **1393** procedime penale me **346** persona të pandehur dhe **312** persona nën hetim, ndër të

cilët **123** kanë qenë me masë sigurimi “Arrest në burg”, ndërsa pjesa tjetër janë ndjekur me masa të tjera sigurimi.

Më poshtë paraqitet grafikisht krahasimi mes numrit të çështjeve të përfunduara gjatë vitit **2023** dhe **2022**, sipas mënyrës së përfundimit:



Për vitin 2023 është vendosur mosfillimi për **395** materiale kallezues. Për të gjitha këto raste është treguar kujdesi i duhur që vendimi të merret mbasi të jenë kryer verifikimet e nevojshme dhe brenda afatit të përcaktuar në ligj. Përgjithësisht është respektuar ky afat me përjashtim të rasteve kur vonesat kanë ardhur për shkaqe objektive, siç është rasti i vonesave të akteve të ekspërtimit kryesisht mjekoligjore etj, por në raste të veçanta edhe për neglizhencë nga oficerët e policisë gjyqësore të ngarkuar për të kryer verifikimet apo edhe nga vetë prokurorët. Mendojmë se politika e ndjekur në rastet e vendimeve të mosfillimit ka shërbyer jo vetëm për të mos harxhuar energji të panevojshme, por edhe për të parandaluar fillimin e ndjekjes penale ndaj personave të cilët në fakt nuk dyshohen të kenë kryer ndonjë vepër penale. Në zbatim të detyrimeve të ligjit procedural penal të gjithë personave të interesuar u janë komunikuar vendimet e mosfillimit duke u dhënë atyre mundësinë për të ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatë.

Nga procedimet penale të mosfilluara janë ankimuar në Gjykatë **20** prej tyre. Gjykata ka lënë në fuqi vendimet e mosfillimit në **17** raste, **1** rast është shfuqizuar dhe rastet e tjera janë ende në gjykim.

Gjatë vitit 2023 janë transferuar **33** procedime penale me **21** të pandehur/persona nën hetim. Kryesisht procedimet penale të transferuara janë derguar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë por edhe në Prokurori të tjera për shkak të kompetencës tokësore dhe lëndore.

HETIMI PARAPRAK

Për vitin 2023 treguesit e arrestimeve në flagrancë dhe ndalimeve të kryera ndaj shtetasve të dyshuar si autorë të veprave penale të ndryshme paraqiten si me poshtë:


Janë arrestuar në flagrancë nga Policia Gjyqësore 126 persona.

Është nxjerrë urdhër ndalimi nga Prokurori/policia gjyqësore dhe është kërkuar në gjykatë caktimi i mases së sigurimit ``arrest në burg`` në mungesë për 12 shtetas.

Në Gjykatë janë dërguar për vleftësimin e arrestit apo të ndalimit 138 persona dhe Gjykata i ka vlerësuar të ligjshme 134 kërkesa dhe 4 kërkesa të cilat ka vlerësuar të paligjshme por ka caktuar masë sigurimi dhe në 2 raste është urdhëruar nga prokurori lirimi i menjëhershëm i të arrestuarit/ndaluarit.

Për këta tregues është kërkuar respektimi me korrektesë i kritereve të përcaktuara në ligjin procedural penal si dhe garantimi i të drejtave të personave që u është hequr liria duke kushtuar një kujdes të veçantë sidomos për respektimin e garancive që u siguron ligji personave të mitur. Në analizën e treguesve bie në sy fakti se pothuajse kërkesat e paraqitura nga prokurori janë vlerësuar të ligjshme nga Gjykata e Shkallës së Parë. Kjo tregon se konsultimi paraprak i oficerëve të policisë gjyqësore që kryejnë arrestet dhe ndalimet me prokuroret e gatshëm që tashmë është një normë në aktivitetin tonë ka dhënë rezultatet e dëshiruara.

Prokuroret kanë kërkuar caktimin e mases së sigurimit “ arrest në burg” për 77 persona ndërsa nga Gjykata është caktuar kjo masë vetëm për 68 persona.



PROCEDIMET PENALE TË PUSHUARA

Janë pushuar gjatë kësaj periudhe kohore **133** çështje, **13** çështje më pak se në vitin 2022 me **48** persona nën hetim.

Nga çështjet e pushuara duke perjashtuar ato për efekt parashkrimi rezulton se :

- **25** procedime janë pushuar për mungesë të faktit penal.
- **63** procedime për mungesë të provave të mjaftueshme.
- **45** procedime për shkaqe të tjera procedurale.

Çështjet e pushuara zënë rreth **26%** të numrit të përgjithshëm të çështjeve të përfunduara në periudhën 1 vjeçare (në këtë llogaritje nuk përfshihen çështjet e transferuara dhe çështjet e pushuara për shkak të parashkrimit).

Megjithatë numri i përgjithshëm i çështjeve të pushuar është relativisht i ulët bie në sy se 63 procedime janë pushuar për mungesë të provave, çka do të thote që kërkohej një analizë më e plotë për shkaqet që kanë çuar në pushimin e tyre të cilat në shumicën e rasteve vijnë për shkak të një hetimi jo të cilësor dhe shterues. Po kështu duke analizuar procedimet e pushuara për mungesë të faktit dhe të elementëve të veprës penale arrihet në konkluzionin se është e nevojshme që gjatë fazës për verifikimin paraprak të materialeve kalëzuese duhet bërë një vlerësim sa më i drejtë i fakteve të paraqitura në këto materiale për të shmangur regjistrimin e procedimeve kur nuk është i nevojshëm. Pjesa tjetër janë çështjet që pushohen për shkak të heqjes dorë nga ankimi prej të dëmtuarve për ato procedime ku ndjekja penale është e kushtëzuar nga vullneti i tij.

Në vitin 2023 nuk është ankimuar asnjë vendim pushimi prokurorit.

Në numrin e përgjithshëm të pushimeve janë të përfshira vendimet e pushimit dhe rastet e kërkesave për pushim në gjykate që janë **105** kërkesa me **31** persona nën hetim nga të cilat për **81** çështje është pranuar kërkesa, në **10** rast është vendosur kthimi i akteve dhe vazhdimi i hetimeve dhe 1 (një) rast pushimi i pjesshëm është vendosur kthim i akteve, formulim akuze dhe paraqitje kërkesë për gjykim dhe pjesa tjetër e kërkesave mbetet në gjykim.

Siç shihet problematikë mbetet numri i lartë i kërkesave për pushim të dërguara në gjykatë kryesisht gjatë viteve 2021-2022 të cilat kthehen nga gjykata për vazhdim hetimesh, në disa raste edhe për herë të dytë apo të tretë, çka ka sjellë një ngarkesë artificiale për prokurorët. Nga analiza rezulton se përveç rasteve kur kthimet janë bërë për shkak të moskryerjes së hetimeve të plota nga prokurorët duhet theksuar se në mjaft raste edhe vendimet e Gjykatës rezultojnë të mos jenë marrë në zbatim të drejtë të Ligjit. E themi këtu mbasi në shumicën e rasteve kthimet nuk kanë sjellë ndonjë gjë të re në mënyrë të perfundimit të çështjes.

PROCEDIME PENAL TË PUSHUARA PËR SHKAK TË PARASHKRIMIT

Vëmendje e veçantë u është kushtuar edhe çështjeve që janë referuar nga Policia për pushim për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Gjatë këtij viti janë dërguar në Gjykate me kërkesë për pushim për parashkrim të ndjekjes penale **676** procedimeve. Këtë ngarkesë punë e kanë përballuar oficeri i policisë gjyqësore Martin Pali dhe Artur Boni, prokurorët Blerina Musabelliu, Julian Çafka dhe Petrit Çano. Për një pjesë të madhe të kërkesave gjykimi ka përfunduar dhe janë njoftuar individët dhe Sektori Kartotekës në DVP Gjirokastrë.

PROCEDIMET PENALE TE PEZULLUARA

Gjatë vitit 2023 janë pezulluar **84** procedime penale, 40 çeshtje me pak se ne vitin 2022 ku numeri i çeshtjeve te pezulluara ka qenë **124** te tilla. Numrin më të madh të procedimeve penale të pezulluara e zënë procedimet për veprën penale “Vjedhja”(neni 134 i K.Penal) me **47** procedime të pezulluara për zbulim autori dhe në numër më të ulët për veprat penale të parashikuara nga nenet 150, 151 dhe 284 të Kodit Penal.

Ajo qe konstatohet këtë vit është fakti se është ulur ne menyre te ndjeshme numri i procedimeve te regjistruara për nenin 134 te K.Penal nga **88** ne vitin 2022 ne **67** ne vitin 2023 dhe ka mbetur në numër të izoluar vepra penale e “Kultivimit të bimëve narkotike” me nga **9** procedime penale për vitet 2022 dhe 2023 çka tregon se politika penale e ndjekur per kete fenomen shume te perhapur në vitet e kaluara ne teritorin tone ka dhene efektet e veta.



CESHTJET ME TË MITUR

Ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Gjirokastrë funksionon Seksioni për te Mitur i cili ka ne përberje te tij një prokuror dhe një oficer te Policisë Gjyqësore . Aktualisht ky seksion po funksionon normalisht mbasi një ndihmese te madhe ka dhënë edhe prania e kordinatores për asistence ndaj subjekteve me status te posaçem.


Gjate vitit 2023 jane regjistruar **41** kallezime per autore dhe viktime te mitur nga te cilet per **32** raste eshte regjistruar procedimi penal , me **30** autore. Jane derguar ne gjykim **7** çeshtje me autore dhe viktime te mitur per veprat penale **100/2, 108/a/2, 130/a/4, 134/1,2, 89, 301, 305/b dhe 291 te K.Penal.**

Ne **14** (katërmbëdhjete raste) eshte vendosur shmangja nga denimi e te miturve autore te vepres penale, konkretisht per veprat penale parashikuar nga neni 291, 134 te K.Penal.

Hetimet per kete kategori personash kane perfunduar brenda afateve te parashikuara ne ligj.

Aktualisht jane ne hetim edhe **11** (njëmbëdhjetë) procedime penale.

Ne zbatim te Urdherit nr.87, dt.28.07.2021 te Prokurorit te Pergjithshem “ Per miratimin e rregullave per perdorimim e Sistemit te Integruar te te Dhenave te Drejtesise Penale per te Mitur”eshte implementuar hedhja e ketyre te dhenave ne sistemin elektronik, risi kjo ne aktivitetn e Prokurorise.




PROCEDIMET E DËRGUARA PËR GJYKIM

Në vitin 2023 janë dërguar për gjykim **290** procedime penale, **20** çeshtje më shume se vitin e kaluar, me **340** të pandehur nga të cilët **86** të arrestuar dhe pjesa tjetër të ndjekur me masa të tjera sigurimi. Procedimet penale të dërguara për gjykim zënë rreth **57%** të numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të përfunduara .

Nga kerkesat e derguara për gjykim **6** raste i përkasin gjykimit Urdhër Penal, **9** raste për Miratim Marrëveshje Fajësie.

Janë kthyer nga gjykata **3** çeshtje për mospranim të urdhërit penal dhe janë ridërguar përsëri me kërkesë për gjykim, **1** çeshtje është kthyer për mos miratimin të marreveshjes së fajesisë e cila është dërguar përsëri me kërkesë për gjykim, **3** çeshtje të kthyer për plotësim hetimesh nga të cilat **2** janë ridërguar në gjykatë dhe **1** çeshtje për marrjen të pandehur të dy personave nën hetim dhe rikualifikim të veprës penale. Fakti që 57 % e çeshtjeve të përfunduara janë dërguar për gjykim tregon për një punë profesionale të mirëfillte të prokurorëve për të mos lejuar që askush që ka kryer vepra penale të shpëtojë ndeshkimit të ligjit.



Në TOTAL në vitin **2023** :

Janë përfunduar 540 procedime penale me **409 (69+340)** persona të nën hetim/të pandehur nga të cilët **89** të arrestuar.

Kanë mbetur në hetim **853** procedimi me **243** persona nën hetim, nga të cilët **34** në masën e sigurisë “*arrest në burg*”. Siç shihet janë **70** procedime më pak se vitin e kaluar. Edhe këtë vit mbetet i lartë numri i çështjeve të mbartura. Arsyet e kësaj lidhen me një sërë shkaqesh objektive dhe subjektive. Në korrik 2023 organikës së Prokurorisë i'u shtuan edhe 3 prokurorë të rinj duke e çuar numrin e prokurorëve në 7 nga 9 që ka organika, duke zgjidhur një problematikë serioze që kishte disa vite, shkak

për këtë rezultatet e procesit të vettingut. Numri i oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit është 5 nga 7 që ka organika. Projeksioni për vitin 2024 është optimist dhe objektivi i institucionit është që të ulet në mënyrë të ndjeshme numri i procedimeve penale të mbartura nga vitet parardhëse.

HETIMET PASURORE

Gjatë vitit 2023 janë regjistruar **10** hetime pasurore dhe janë mbartur nga vitet e kaluara(2019-2022) **68** hetime pasurore nga të cilat është përfunduar vetëm **1** (një) hetim pasuror i vitit 2021 i cili është pushuar.

Ngarkesën më të madhe të hetimeve pasurore e mbart prokurori Gazmend Frëngu i cili ka pasur në hetim **49** çështje.

Gjithësesi duhet pranuar që për këtë kategori veprash rezultatet nuk kanë qenë ato që priten dhe që janë përcaktuar si prioritare edhe në Rekomandimet e Keshillit të Ministrave për luftën ndaj kriminalitetit. Ka zvarritje të pajustificueshme në hetim, ka mungese profesionalizmi nga oficerët e policisë gjyqësore që kryejne hetimin, nuk ka struktura të posaçme në Polici dhe oficerë të trainuar, ndodh që në shume raste prokurorët nuk adresojnë dot oficerin të cilit do ti delegohet çështja. Në shume raste pergjigjet nga organet në të cilat kerkohet informacion vijne me vonese dhe po keshtu zvarrtje jane krijuar dhe nga ekspertet kontabel te thirrur per te bere aktet perkatese ne kuader te ketyre ceshtjeve.

MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT PP-DPPSH **NENI 59 KODIT PENALE**


Në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr.15, datë 30.10.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm, gjatë vitit 2023 janë trajtuar 109 materiale të përcjella nga shërbimet e policisë në DVP Gjirokastrë dhe Komisariatet e Policisë Gjirokastrë, Tepelenë dhe Përmet, 14 materiale më shumë se në vitin 2022, nga të cilat janë regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale 4 materiale.

ZGJATJET E AFATIT TË HETIMEVE

Është me vend të përmendim se gjatë këtij viti janë konstatuar zgjatje të panevojshme të afatit të hetimit për procedime të caktuara për shkaqe subjektive, për moskryerje të detyrave nga oficerët e policisë gjyqësore dhe mungesë kontrolli nga prokurorët e çështjeve.

Gjatë 2023 janë zgjatur afatet e hetimeve ***deri në tre muaj*** për **57** procedime me **60** të pandehur ose persona nën hetim nga të cilët **32** kanë qenë me masë sigurimi “arrest me burg”, ***mbi tre muaj*** për **27** procedime me **36** të pandehur nga të cilët **22** të arrestuar, ***mbi 6 muaj deri në 9 muaj*** për **14** procedime me **18** të pandehur/persona në hetim nga të cilët **7** të arrestuar, ***mbi 9 muaj deri 1 vit*** për **2** procedimet me **2** të pandehur/persona në hetim nga të cilët **1** i arrestuar dhe ***mbi 1 vit*** për **6** procedime me **7** të pandehur/persona në hetim pa masa sigurimi arrest në burg.

Këto të dhëna tregojnë se kërkohet më shumë vëmendje, më shumë kontroll nga prokurorët e çështjeve, por edhe nga drejtuesi i prokurorisë për të eliminuar zvarritjet dhe për të zgjidhur çështjet brenda afatave procedurale.



NGARKESA E PROKUROREVE DHE OFICEREVE TE POLICISE GJYQËSORE

Treguesit e punës për secilin prej prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore janë si më poshtë:

Prokurori	Dërguar në gjyq	Pushuar	Pezulluar	Shpallur moskompetenca	Bashkuar	Procedime penale të përfunduara	Mosfilluar	TOTAL PERFUNDUAR
Petrit Çano		676				676		
Julian Çafka	27	22	7	1	1	58	10	68
Asllan Barjamaj	7	3	0	1	0	11	10	21
Arjan Muçaj	5	6	2	1	0	14	24	38
Ermira Manelli	42	7	8	1	0	58	45	103
Gazmend Frëngu	50	4	8	13	2	77	66	143
Denisa Plaku	56	17	15	4	3	95	56	151
Blerina Musabelliu	57	42	18	4	1	122	83	205
Nertila Miftaraj	13	13	2	3	3	34	40	74
Bledar Bala	18	10	12	3	0	43	41	84
Maringlen Meta	15	9	12	2	0	38	20	58
TOTALI								
	290	133 + 676	84	33	10	550 + 676	395	945 + 676
								1621

Vo. Ne treguesin e çeshtjeve te pushuara jane perfshire edhe çeshtjet e pushuara per efekt te parashkrimit te vepres penale.

Ne TOTAL duke perfshire procedimet e perfunduara, mosfillimet dhe çeshtjet e pushuara per shkak parashkrimi, jane perfunduar nje numer prej **1611** çeshtjesh.

Oficeri i Policisë Gjyqësore Martin Pali:

Ka trajtuar gjithsej **8** procedime, nga të cilat

- Ka përfunduar **2** procedime penale.
- Ka referuar për dërgim në gjyq **1** çështje.
- Ka referuar për pezullim **0** çështje.
- Ka referuar për pushim **1** çështje.
- Mbeten në hetim **6** çështje.

VO. Ky oficer eshte edhe pjese e seksionit te Ekzekutimit te Vendimeve Penale dhe ka perballuar nje ngarkese te konsiderueshme edhe ne kete seksion ku ka perpiluar 216 urdhera ekzekutimi(burgim, gjobe, sherbim prove, shpenzime procedurale) si dhe raporte perfundimtare, kërkesa/vendime pushimi për parashkrim, leterporosi, urdhera kerkimi nderkombetar dhe kerkesa per bashkim apo revokim denimi dhe korrespondencën me Prokurorinë e Përgjithshme, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, institucione të ndryshme

Oficeri i policisë gjyqësore Artur Boni:

Ka trajtuar gjithsej **107** procedime, nga të cilat

- Ka përfunduar **78** procedime penale.
- Ka referuar për dërgim në gjyq **54** çështje.
- Ka referuar për pushim **13** çështje.
- Ka referuar për pezullim **7** çështje.
- Ka referuar për mosfillim **4** çështje.
- Mbeten në hetim **29** çështje.

Oficeri i Policisë Gjyqësore Agron Nakollari:

Te trajtuara gjithësej **149** procedime penale

Ka përfunduar gjithsej **115** procedime, nga të cilat:

- **40** janë referuar për pushim procedimi.
- **68** janë referuar për dërgimin e procedimit në gjyq .
- **6** janë referuar për pezullim.
- **1** janë referuar për transferim.
- **34** procedime mbeten në hetim.

Oficeri i Policisë Gjyqësore Erlin Lani.

Ka trajtuar gjithsej **156** procedime, nga të cilat

- Te perfunduara **99** procedime.
- **69** janë referuar për dërgimin e procedimit në gjyq.
- **7** janë referuar për pezullim.
- **3** është referuar për transferim
- **20** procedime referuar për pushim
- **57** procedime mbeten në hetim
- Gjithashtu për **23** procedime penale oficeri ka kryer e përfunduar veprimet lidhur me njoftimet e akteve, apo veprimeve të tjera hetimore.

Oficeri i Policisë Gjyqësore Clirim Puto

Ka trajtuar gjithsej **155** procedime, nga të cilat

- Te perfunduara **95** procedime.
- **63** janë referuar për dërgimin e procedimit në gjyq.
- **10** janë referuar për pezullim.
- **18** procedime referuar për pushim
- **4** procedime referuar për transferim
- **53** procedime mbeten në hetim
- Gjithashtu për **7** procedime penale oficeri ka kryer e përfunduar veprimet e posaçme të deleguara.

GJYKIMI

Për vitin 2023 kanë qënë në gjykim **490** çështje me **543** të pandehur nga të cilët **94** të arrestuar dhe kanë përfunduar gjykimin për **151** procedime me **171** të pandehur nga të cilët **33** të arrestuar.

Janë mbartur në gjykim **339** procedime penale me **372** të pandehur nga të cilët **61** të arrestuar.

Për 143 procedime është zhvilluar gjykim i shkurtuar me 164 të pandehur.

Për 2 procedime është zhvilluar gjykim i zakonshëm me 2 të pandehur.



Për 5 procedime është zhvilluar gjykim i drejtëpërdrejtë me 5 të pandehur.

Nga prokurori është kërkuar dënimi me burgim për **38(7 burgim minimal + 31 burgim mesatar)** të pandehur dhe nga Gjykata është caktuar dënimi me burgim për **30** të pandehur.

Për 14 të pandehur prokurori ka kërkuar dënimin me gjobë dhe nga gjykata janë dhënë dënime me gjobë për **14** të pandehur.

Ndërsa nga 118 kërkesa të prokurorit për pezullim të ekzekutimit të vendimit Gjykata ka dhënë këtë lloj dënimi për **120** të tilla.

Më poshtë paraqiten grafikisht llojet e dënimeve të kërkuara nga prokurorët dhe mënyra se si ka vendosur gjykata.



Për vitin 2023 gjykata ka vendosur për 6 pafajësi për të cilat është ushtruar ankim

Për fazën e gjykimit i është kushtuar rëndësi sigurimit të provave të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurve si dhe diferencimit të llojit dhe masës së dënimit në varësi të veprës penale të kryer.

Për veprat penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si ato kundër jetës dhe shëndetit, veprat penale në fushën e narkotikëve, kontrabandimit të klandestineve, krimet në fushën e doganave, vjedhjet,

mashtrimet, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, etj. kërkesat tona për llojin dhe masën e dënimit kanë synuar ne parandalimin dhe ndëshkimin e këtyre veprave penale. Ky qendrim me sa konstatohet është reflektuar ne kategorine e veprave penale kundër rendit dhe sigurise publike si dhe veprat penale kunder pasurise te cilat rezultojne ne nje renie te lehte por gjithashtu nga grafiket e pasqyruar ne faqet e para te kesaj analize rezulton se veprat penale jetes dhe shendetit, kunder autoritetit te shtetit dhe kunder drejtesise kane pesuar nje rritje te lehte ne krahasim me një vit me pare cka do te thote se prokuroret duhet te rishohin qendrimin e tyre ne gjykate për keto kategori veprash duke e bërë më fleksibël dhe duke e përshtatur me format dhe tendencat e kriminalitetit në Qarkun tonë.

Gjatë vitit 2023 kanë qenë **9** rastet kur prokurorët kanë apeluar vendimin e Gjykatës për ndryshim akuze apo për lloj dhe mase dënimi.

Është ushtruar e drejta e ankimit edhe kundër vendimeve për masat e sigurimit në **8** raste nga prokurori te cilat vetëm një rast është pranuar nga Gjykata.

Ne **47** raste kanë ushtruar te drejten e apelimit te pandehurit dhe Gjykata ka rrezuar kerkesen e tyre ne **90%** të rasteve.

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE

Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Gjirokastër gjatë kësaj periudhe kohore ka kryer edhe detyrimet procedurale në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale. Prokurorët **Blerina Musabelliu, Arjan Muça, Asllan Barjamaj, Maringlen Meta** të ngarkuar me këtë detyrë në periudha të ndryshme **dhe oficeri i policisë gjyqësore Martin Pali** gjatë vitit 2023 kanë urdhëruar ekzekutimin e **216** vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Prej tyre:

Janë nxjerrë 35 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve me burgim nga te cilet janë ekzekutuar **35** urdhëra.


Janë nxjerrë 39 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve me gjobë nga te cilet janë ekzekutuar **4** urdhëra.

Janë nxjerrë 142 urdhëra për ekzekutimin e dënimeve alternative të cilët rezultojnë të jenë ekzekutuar **141** urdhëra.

Janë ekzekutuar gjithsej 180 urdhëra

Ngelen pa u ekzekutuar gjithsej 36 urdhëra

Gjithashtu janë kryer edhe detyrimet e tjera që lidhen me ankimet e palëve në Gjykatë gjatë fazës së egzekutimeve. Mbetet ende problem egzekutimi i dënimeve me gjobë, kjo kryesisht për shkaqe objektive (pamundësinë e pagimit të tyre nga personat e dënuar), por në ndonjë rast edhe për moskryerje të detyrës nga organet përmbarimore.



Po kështu gjatë këtij viti janë shqyrtuar në Gjykate me pjesëmarrje të prokurorit kërkesa të veçanta në fazë ekzekutimi, gjithësej **17** (shtatembedhjetë) çeshtje nga të denuarit që ndodhen në Institucionet e vuajtjes së dënimit në territorin që ushtron funksionet Prokuroria Prane Gjykeses së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokaster. Me konkretisht janë përfunduar në Gjykate **2** kërkesa për “Lirim me kusht” të cilat janë pranuar nga Gjykata, **5** kërkesa për “parashkrim dënimi”, **3** kërkesa për “rivendosje në afat të ankimit” të treja të rezuara dhe **1** kërkesë për ulje dënimi e cila është pranuar. Mbeten në gjykim **2** kërkesa për “bashkim dënimesh”, **1** kërkesë për “lirim me kusht”, **1** kërkesë për “parashkrim dënimi”, **1** kërkesë për “llogaritje të kohës së paraburgimi”, **1** kërkesë për “kundershtim të urdherit të ekzekutimit”.

Në total nga **17** çeshtje të regjistruara janë përfunduar **11** dhe mbeten në proces gjykimi **6** çeshtje.

MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA

Kemi pasur **6** (gjashtë) kërkesa për ndihmë juridike (leterporosi) nga autoritete të huaja, 1 (një) kërkesë për ekstradim nga Venezuela i një shtetasi venezuelian të dënuar nga Gjykatat e Rrethit Gjyqësor Përmet për veprën penale të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal e cila nuk është pranuar nga autoritetet venezueliane të drejtësië, por është kërkuar njohja e vendimit penal nga gjykatat venezueliane dhe 1 (një) rast ekstradimi nga jashtë për një shtetas për veprën penale të parashikuar nga neni 76-22 i Kodit Penal.

TRANSFERIMI I PROKURORËVE

Gjatë vitit 2023 katër prokurorë të Prokurorisë Prane Gjykeses së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokaster janë transferuar në Prokurori të tjera konkretisht në Tiranë dhe Ebasan të cilat kanë lënë një ngarkesë të mbartur në hetim prej 444 çeshtje (përfshi këtu edhe çeshtjet e ardhura nga Prokuroria Përmet) si dhe 147 çeshtje në proces gjykimi.

Cështjet në hetim të prokurorëve të transferuar janë shpërndarë midis prokurorëve Gazmend Frëngu, Maringlen Meta, Nertila Miftaraj dhe Bledar Bala ndersa cështjet në gjykim janë shpërndarë në mënyrë të barabartë midis gjithë prokurorëve. E gjej me vend të falenderoj të gjithë prokurorët (duhet theksuar se janë të gjithë të rinj) për perkushtimin dhe gadishmerinë e treguar në përballimin e ngarkesës së mbartur dhe të nxisur që të bëjmë të gjitha përpjekjet për ta përmirësuar sa më shpejt këtë tregues.

VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE

Gjatë vitit 2023 në veprimtarinë administrative të organit të Prokurorisë Prane Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokaster janë reflektuar ndryshimet e ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë “ dhe ligjeve të tjera në kuadër të Reformës në Drejtësi përfshi këtu edhe Hartën e re Gjyqësore

Në këtë kuadër është kërkuar zbatimi i Regullores “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë prane Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokaster të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm në të cilën janë përcaktuar në mënyrë specifike detyrat e çdo punonjësi të administratës. Me urdhera të brendshme dhe Udhezime të Përgjithshme të nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë mbi bazën e Udhezimeve të derguara nga Prokurori i Përgjithshëm është normuar puna për administrimin e regjistrave, për shpërndarjen e çështjeve nepërmjet shortit , për organizimin dhe koordinimin e punës në prokurori, për të unifikuar praktiken e ndjekur nga prokurorët për realizimin e përgjimit, rregullat për administrimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të përgjimit, për trajtimin e materialeve të klasifikuara nga personat që e kanë këtë akses dhe në mënyrë të vecantë për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga K.Pr.Penale por edhe nga Udhezimi nr.05 dt. 26.10.2018 i Prokurorit të Përgjithshëm “ Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale si dhe Udhezimit të Përgjithshëm nr.17 dt. 23.12.2021 “Për hetimim dhe ndjekjen penale efektive të veprave penale kundër dhunes ndaj grave , dhunes në familje dhe dhunes me baze urrejtje”. Është krijuar regjistri i komunikimeve të brendshme në Prokurori i cili garanton transparencën e mardhenieve dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve nga palët. Është bërë përpunim i dukshëm në mënyrën e administrimit të të dhënave dhe përgatitjen e statistikave për informimin në kohë reale të Prokurorit të Përgjithshëm. Po kështu është përmirësuar ndjeshëm sistemi i arkivës së Prokurorisë, është bërë inventarizimi, vlerësimi dhe përcaktimi i afatëve të ruajtjes së materialit arkivor. Në këtë kuadër është pershtatur godina e ish Prokurorisë Tepelene dhe është sistemuar atje një pjesë e madhe e fondit arkivor të Prokurorisë Gjirokaster dhe ish Prokurorisë Tepelene dhe Permet.

Gjatë vitit 2023 është treguar kujdes i vecantë për të trajtuar me përparësi dhe efektivitet për tu ardhur sa më parë në ndihmë qytetarëve për shqetësimet e ngritura nga palët në proces, është kërkuar në vazhdimësi që prokurorët të jenë korrekt me qytetarët, me vartësit, me kolegët, të ruajnë një figurë të pastër etiko-morale duke i shërbyer në radhë të parë vetes, por edhe ruajtjes së një imazhi të pastër të Institucionit. Në funksion të kësaj në zbatim edhe të Udhezimit të Përgjithshëm “ *Per mardheniet me publikun*” prokurori i caktuar me këtë detyrë Denisa Plaku është përpjekur të bëjë transparencë për çështje sensitive që shqetësojnë komunitetin.

Është me vend të theksojmë edhe përkushtimin e treguar nga personeli administrativ i kësaj prokurorie, kryesekretari, përgjegjësi i degës së buxhetit, sekretaret dhe punonjësit e shërbimeve mbështetëse, puna e të cilëve ka qenë mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e Policisë

Gjyqësore në ushtrim të detyrës së tyre, por edhe për qytetarët të cilëve u janë ofruar shërbime administrative të cilësisë së lartë.

Për vitin 2023 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokaster ka patur fonde buxhetore faktike në shumen totale **98 963 174** leke të realizuara këto në ndarjen e Artikujve si më poshtë :

600 “Paga të personelit të perhershëm” në shumen	75 087 600
601 “Kontribute të sigurimeve shoqërore “ në shumen	7 005 004
602 “Mallra e shërbime” në shumen	16 270 205
606 “Shpenzime të tjera” në shumen	113 200
231 “Investime” në shumen	487 165

Pjesën më të madhe e zënë shpenzimet për honoraret ku përfshihen shpenzimet për avokat, ekspert të ndryshëm , perkthyes, shërbime kadastrale dhe shpenzimet për sigurinë dhe ruajtjen fizike të objektit të Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokaster dhe ruajtjen e ish godinës së Prokurorisë Tepelene e cila është pershtatur për ambiente si arkive gjyqësore. Faturat ndaj të tregëve janë shlyer në kohë dhe gjendja në fund të vitit për faturat e palikujduara është **114 200** leke që i perkasin faturave mujore (dhjetor 2023). Për të gjitha rastet e gadishmërisë dhe mbikohës së punës të cilat janë evidentuar në mënyrë të plotë, kapin shifrën **1092** orë për të cilën punonjësit e kësaj Prokurorie janë paguar.

Struktura organike në këtë prokurori ka funksionuar sipas strukturs së dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresë nr.1025/11 Prot, datë 26.06.2023. Ndërsa për periudhën në vazhdim ndryshimet gjatë vitit, shtesat ose pakesimet janë bërë me urdher të Prokurorit të Përgjithshëm, në zbatim të nenit 8 të ligjit nr.8737, datë 12.02.2001 “ Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

Në lidhje me ambientet e institucionit kemi në përdorim katin e tretë të godinës së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokaster ku konkretisht janë 10 zyrë që përdoren nga personeli. Nisur nga zbatimi i hartës së re gjyqësore ku personeli i Prokurorisë Permet është përthithur nga Prokuroria Gjirokaster, për ambientet e institucionit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokaster është e domosdoshme shtimi i tyre me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë normale të punës. Aktualisht në këtë prokurori ushtrojnë detyrën 7 prokurorë bashkë me drejtuesin e institucionit, 5 oficerë të policisë gjyqësore ndërkohe që organika e plotësuar do të jetë 9 prokurorë dhe 7 oficerë të policisë gjyqësore.

Nga sa më sipër kërkojmë që të merret në konsideratë zgjidhja e kësaj problematike duke marrë nga ambientet e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokaster ambientet e katit të dytë të kësaj godine (pasi ka dhe komunikim me dëre midis dy institucioneve). Me zgjerimin e ambienteve do të jetë e nevojshme të behen dhe investime të reja me pajisje zyrash, infrastrukture elektrike dhe rrejtesh kompjuterike.

Nga analiza në tërësi e elementëve që u përmendën më lart për vitin në vazhdim prioritet kryesorë do të jenë :

1. Implementimi me sukses i gjithë ndryshimeve në K.Penal dhe K.Pr.Penale duke duke i dhene perparësi pavarësisë së prokurorëve në vendimmarrje por edhe aplikimit të instituteve të reja të parashikuara në këto Kode.
2. Përfundimi në një kohë sa më të shkurter të gjitha çështjeve të mbartura ndër vite.
3. Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të procedimeve penale në fushën doganave dhe kufitare, kontrabandimit të emigrantëve të paligjshëm, shitjes, shpërndarjes dhe trafikimit të lendeve narkotike, kultivimit të bimëve narkotike ku ka rezultuar se në vitet e fundit lufta ndaj këtij fenomeni ka dhënë frytet e veta duke ulur ndjeshëm rastet e kultivimit në qarkun Gjirokastrë, veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, abuzimit me detyrën të nëpunësve shtetërorë, veprat penale kundër jetës, shëndetit, veprave penale të kalëzuara nga ILDKPI, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Sektori i Verifikimit të Integritetit të Personave të Zgjedhur në Prokurorinë e Përgjithshme, veprat penale kundër femijëve, martesës dhe familjes me objekt të vecantë veprat penale kundër dhunës në familje, veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, në veçanti shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, krimet mjedisore ku në qarkun Gjirokastrë ndodhen parku Kombëtar i "Lumit të Vjoses" ku përfshihen luginat e lumenjve Drino dhe Bençe, parku Kombëtar i "Bredhit të Hotoves", zonat e mbrojtura natyrore, muzeale e arkeologjike dhe çdo lloj forme tjetër të krimit që konsiderohet shqetësuese për komunitetin ku ushtrojmë detyrën.
4. Trajtim rigoroz i çështjeve me autore dhe viktimë të Mitur duke u dhënë perparësi interesit me të lartë të tyre, duke respektuar të gjitha rregullat e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur dhe duke zbatuar një politikë ndjekje penale dhe denimi që ti shërbejë edukimit dhe integritetit të tyre në shoqëri.
5. Rritja e numrit të hetimeve proaktive dhe përdorimit të teknikave speciale të hetimit, kryerja e hetimeve sistematike pasurore për të gjitha rastet e parashikuara në ligj me synim sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive me burime kriminale.
6. Ndjekja në vazhdimësi e çështjeve për ngjarje kriminale të rënda të pezulluara në vitet e mëparshme dhe në këto kuader forcimi i bashkëpunimit me Policinë Gjyqësore dhe organet e tjera ligjzbatuese me qëllim për të mos lejuar askënd t'i shpëtojë ndëshkimit ligjor për veprat e kryera.
7. Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit në hetimet paraprake të kryera nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore.
8. Përmirësimi i organizimit, drejtimit dhe kontrollit brenda organit të Prokurorisë në përputhje me Ligjin nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", si dhe "Rregullores Standarte të Organizimit dhe Funksionimit të Prokurorisë të Juridiksionit të Përgjithshëm" për tu pershtatur me ndryshimet e këtij ligji me synimin për t'ju përgjigjur në kohë dhe me cilësi kërkesave të luftës kundër kriminalitetit, forcimit të disiplinës së brendshme dhe të vullnetit për të identifikuar çdo lloj problematike brenda organit dhe për ta goditur atë përpara se të ndodhë.
9. Respektimi i detyrimeve të ligjit procedural penal, rekomandimeve të Këshillit të Ministrave për luftën kundër kriminalitetit dhe Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm në këto drejtim.
10. Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional sidomos me Prokurorinë Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit me qëllim shkëmbimin në një kohë sa më të shpjegjete të informacionit për

goditjen ne kohe te te gjithë rasteve korrutive, me Policine e Shtetit por edhe me te gjitha organet e tjera ligjzbatuese.

11. Rritja e profesionalizmit të prokurorëve kjo nepermjet ndjekjes se trainimeve vazhduese ne Shkollen e Magjistratures si dhe ruajtja e një figure morale të pastër jashtë çdo ndikimi per te perfaqesuar ne menyre dinjitoze Institucionin ne raport me publikun, brenda dhe jashte orarit te punes.

Gjirokaster, me 28.02.2024

DREJTUESI I PROKURORISË

PETRIT ÇANO

